

Lekë Sokoli, studiues e botues me vlerë e rendiment të lartë.

Prof. Hamit BEQJA, akademik



(Gazeta "Tirana Observer, 11 nëntor 2006)

1.

Këto ditë, më 1 nëntor 2006, përjetova një gëzim të veçantë. Kisha përpara 4 libra të botuara nga kolegu dhe mik i im, sociologu i njohur, Lekë Sokoli. Libra të freskët të të njëjtit autor. Nuk është pak kur të bien në duar brenda një dite. Nuk ke se si të mos emocionohesh.

Ç'janë këta libra? Të gjithë nga fusha e sociologjisë.

I pari "Sociologjia dhe jeta e përditshme". Shkrime nga sociologjia publike. Një tufë asish të botuara këta tetë muajt e fundit (shkurt – gusht 2006) në gazetën "Tirana Observer". Shkrime të gjinive nga më të ndryshmet. Nga një opinion, po themi tepër i këndshëm për një udhëtim turistik në Moskë, te një shkrim i një natyre krejt tjetër. Analitik, kritik, madje edhe disi direktiv. Për problemet e botimeve të sotme dhe për rrugët e përmirësimit të tyre.

I dyti "Bibliografia e mendimit sociologjik shqiptar" (vitet 1986 - 2006) e hartuar në bashkëautorësi. Edhe këtu Sokoli ka tërhequr mendimin e kolegëve. Që i janë përgjigjur shpejt kërkesës së tij. Por ka lënë vend edhe për të tjerë. Që nuk kanë patur mundësi ta bëjnë këtë kaq shpejt dhe që do ta bëjnë kur t'u krijohet mundësia. Nuk po flas për librin tjetër të vlefshëm, i cili quhet "Trafikimi, rasti i Shqipërisë". Temë edhe kjo e trajtuar në bashkëautorësi. Nuk po zgjatem, gjithashtu, as me librin e tij të katërt. Quhet "Analiza sociologjike". Katër libra në një ditë. Dhuratë e çmueshme. Aq më tepër kur të nderojnë me të.

2.

Kush është Lekë Sokoli? Cili është zhvillimi i këtij njeriu që arrin të të japë në duar momentalisht tre-katër libra? Si e arrin ai këtë? Si paraqitet kjo në rrugën e zhvillimit të tij? Cilët janë gurët kilometrikë të kësaj rruge? Kësaj pyetjeje mund t'i japë përgjigje kushdo që sot e njih veprimtarinë e shumëanshme e shumëvlerëshe të Sokolit. Është ndër sociologët më të shquar shqiptarë. Drejtor i Institutit të sapoformuar të Sociologjisë. Botues i revistës tepër serioze, do të thosha nga më seriozet, "Politika dhe Shoqëria".

3.

Ndeshemi me një sociologji pjellore në vëllim, në cilësi dhe në teknika. Pa e rritur, mund të themi, për t'u habitur! Libra fundamentale nga historia e sociologjisë. Për autorë të huaj dhe shqiptarë. Manuale të një bagazhi të lartë teorik, të harmonizuara me vëzhgime përditësore, të dala nga një dorë që e njih shkëlqyeshëm teknikën e paraqitjes të materialit sociologjik. Anketime me mjetet më të pasura të studimit. Të një niveli krejt bashkëkohor. Pjesëmarrje në diskutime sociologjike publike. Bashkëbisedime për probleme sociologjike me njerëz të shtresave e qarqeve të ndryshme shoqërore.

4.

Çfarë spikat në këtë veprimtari? Cilët janë kriteret themelore që e udhëheqin sociologun? Po shënojmë të parin: **Parimin e gjithëpërfshirjes** të njerëzve në diskutime sociologjike. Së dyti: **Parimin e pranimit të debatit të lirë**, të diskutimeve ku pjesëmarrësit mund t' i shtrojnë çështjet ashtu si u duhet atyre.

5.

Cilat janë levat që e kanë mundësuar Sokolin të arrijë në këtë nivel veprimtarie? Ato janë shumëllojshme dhe shumëkrahëshe. Ka në to edhe nga fëmijëria. I rritur në mjedise të lira ku ka mundur të çmojë komunikimin pa pengesa dhe synimin për të bërë gjithçka vetë. I ndërthurur shpejt në jetë. Edhe në kushte të vështira të periudhës së monizmit të njohur shqiptar. Të shoqëruara këto me përpjekje krejtësisht të reja për kohën. Që i dolën atij në kapërcyellin e kalimit nga totalitarizmi në demokraci. Është për t'u theksuar përfitimi i tij nga pjesëmarrja në emigracion e jeta jashtë vendit. Në dy drejtime themelore. Për t'u njohur me jetën duke punuar qoftë edhe kamarier. Në anën tjetër duke përfituar nga mundësitë edhe për t'u marrë me studime. Duke e filluar me botime revistash që jashtë shtetit.

6.

Nuk mund të le pa përmendur fillimet e njohjes time personale me Sokolin. Në fundin e viteve të regjimit monist kam pasur rastin të asistoj në mbrojtjen e disertacionit të tij. Madje kam qenë edhe recenzent. Është fjala për një studim të mirëfilltë mbi organizimin e punës, i cili rezultoi edhe si libri i parë sociologjik i botuar prej tij. Pastaj bashkëpunimi ynë ka ardhur duke u rritur. Në radhë të parë me iniciativën e vetë Sokolit. Nëpërmjet studimeve dhe botimeve të tij mbi drogën. Deri te një studim i përbashkët, i botuar – “Divorci, vrojtime e refleksione”. Kuptohet për ta vazhduar këtë rrugë intensive bashkëpunimi. Në të cilën kolegu im i nderuar ka ardhur duke u rritur çdo ditë.

7.

Ndoshta është e nevojshme të bëhet edhe një portret pak intim i pamjeve që paraqet **personaliteti i Sokolit**.

Fizikisht - një burrë tepër i mbajtur, i shkathët, në mish të vet, që e ruan dhe di ta përdorë shëndetin.

Në praktikën jetësore njeri i gjithanshëm. Nuk harton vetëm libra. Mos u çuditni, bën edhe muratorin, edhe zdrukthëtarin, edhe karpentierin.

Për **anën intelektuale** është e tepërt të flasim, pasi ajo del qartë. Por faktet flasin vetë. Një nga shqiptarët e paktë, në mos i vetmi, që ka lexuar gati të tërë Frojdit dhe që ka shkruar vërtetë opionime shumë të vlefshme për të.

Politikisht - njeri i depolitizuar në kuptimin më të mirë të kësaj fjale. Që ruhet të mos bjerë në njëanshmëri subjektive. Që respekton mendimin ndryshe. Që i hap rrugë paraqitjes së mendimeve ndryshe.

Moralisht - njeri me ambicie të shëndoshë. Edhe kjo në kuptimin më të mirë të fjalës. Që synon të nxjerrë veprimtari të dobishme e jo për të kaluar radhën.

Familjarisht - njeri tepër korrekt dhe që përballon detyrime nga më të mëdhatë. Si bashkëshort, si baba dhe në marrëdhënie të tjera me shokë, miq, bashkëpunëtorë.

Nga tërë kjo paraqitje mund të mendohet se unë, Hamit Beqja, po bëj një portret pak idilik të Sokolit. Nuk ka njeri pa ndonjë të metë. Do të veçoja atë që ndodh me një njeri që punon shumë. Nuk përjashtohen edhe elementët e nxitimit. Sado që nuk e zbehin në asnjë mënyrë figurën e tij.

Pas kësaj paraqitje tërësore të veprimtarisë së Sokolit, ne i dëshirojmë kolegut tonë arritje gjithnjë e më të reja. Dhe kemi besim të plotë se ai do t'i përmbushë urimet tona. Nuk mund të jetë ndryshe.

Në fund po japim **një gjykim tërësor**. Kemi folur për një njeri që është në kulmin e lulëzimit të forcave, të talentit, të punëve të tij të shumënumërshme.
I uroj të gjitha të mirat !